



**PING PONGU I GJYQËSORIT ME TË  
DREJTËN E TRASHËGIMISË  
TË KËRKUAR NGA  
ZNJ. AFËRDITA STATOVCI**

*(Prona objekt i kontestit të trashëgimisë,  
13 vjet zvarritje, 2 herë lënda e kthyer në rigjykim)*

**Prishtinë, 28 qershor 2019**

Autorët: CLARD dhe  
QENDRA PËR NDIHMË JURIDIKE  
E INSTITUTIT TË KOSOVËS PËR DREJTËSI

*Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e CLARD dhe Qendrës për Ndhmë Juridike të Institutit të Kosovës për Drejtësi.*

CLARD  
Rr. Bardhyl Qaushi,  
Hyrja E, nr.7.  
Prishtinë  
E: clardkosovo@gmail.com  
www.clardkosovo.org

IKD  
Rr. Rrustem Statovci  
Hyrja 1, nr.1 dhe Z3-S4. nr.1  
Prishtinë  
E: info@kli-ks.org  
www.kli-ks.org

## Përmbajtje

I.	Hyrje .....	3
II.	Historiku i të drejtës së trashëgimisë në rastin e znj. Afërdita Statovci.....	4
III.	Kronologjia e zvarritjes 13 vjeccare (2006-2019) të procesit gjyqësor për trashëgimi të znj. Afërdita Statovci .....	5
IV.	Shkeljet e parimeve dhe dispozitave kushtetuese dhe ligjore në trajtimin e rastit të znj. Afërdita Statovci .....	6

## I. Hyrje

- Organizata CLARD dhe Qendra për Ndihmë Juridike e Institutit të Kosovës për Drejtësi (QNJ - IKD) në kuadër të fushëveprimtarisë së tyre ofrojnë për qytetarët në nevojë mbrojtje juridike falas. Në këtë drejtim, CLARD për më shumë se dhjetë vite ka ofruar ndihmë juridike në përfaqësimin e znj. Afërdita Statovci për realizimin e të drejtës së saj në trashëgimi. Prej vitit 2006, paditësja Statovci ka filluar procedurën trashëgimore me qëllim të njohjes së të drejtës ligjore, respektivisht të ½ së pronës të cilën babai dhe axha i saj e kishin blerë në vitin 1975. Ajo në pajtim me ligjin mbi Procedurën Kontestimore dhe Ligjin mbi Trashëgiminë, kishte ushtruar padi ndaj shitësit dhe axhës për bartjen e patundshmërisë, dhënies së tapisë dhe përcaktimit të së drejtës së patundshmërisë.

Prej fillimit të procesit gjyqësor, sipas padisë së znj. Afërdita Statovci, CLARD vazhdimisht ka përfaqësuar znj. Statovci dhe ka sensibilizuar akterët institucional dhe publikun në lidhje me shkëljet e vazhdueshme në trajtimin jo të drejtë, të paanshëm, profesional dhe në kohë të arsyeshme të rastit të padisë së znj. Afërdita Statovci.

Për 13 vite rreshtë, në kërkim të së drejtës së trashëgimisë, znj. Afërdita Statovci ka përjetuar ping pongun e shkallëve të gjyqësorit, të cilat dy (2) herë kanë kthyer lëndën e saj në rigjykim. Zvarritjet në trajtimin e kësaj lënde, janë të natyrave të ndryshme, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në shkëljen e të drejtave elementare të palës paditëse, duke shkelur parimet kushtetuese dhe ligjore si dhe praktikat e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat janë të zbatueshme në Republikën e Kosovës.

CLARD dhe QNJ – IKD kanë bashkuar forcat në adresimin e mëtejme të çështjes së shkëljes së të drejtave të paditëses znj. Afërdita Statovci. Këto organizata do të vazhdojnë të përfaqësojnë rastin e znj. Statovci, duke shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, përfshi ngritjen e rastit në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## II. Historiku i të drejtës së trashëgimisë në rastin e znj. Afërdita Statovci

- Prona e cila është objekt i kontestit të znj. Afërdita Statovci është blerë në vitin 1975 nga babai dhe axha e paditëses.
- Prona përbëhej nga  $\frac{1}{2}$  e shtëpisë prej 60m<sup>2</sup> në fshatin Sllatinë e Madhe, komuna e Fushë Kosovës,  $\frac{1}{2}$  e 65m<sup>2</sup> e shtëpisë numër 2, në fshatin Sllatinë e Madhe, komuna e Fushë Kosovës,  $\frac{1}{2}$  e parcelës tokë (*ndërtimore, bujqësore, kullosë e klasës së parë*) në fshatin Sllatinë e Madhe, komuna Fushë Kosovë, në sipërfaqe prej 657m<sup>2</sup>;  $\frac{1}{2}$  e parcelës prej 361m<sup>2</sup>, në fshatin Harilaq, komuna e Fushë Kosovës.
- Prona e lartë-përmendur ishte blerë në vitin 1975 dhe figuronte në emrin e shitësit por e njëjta pronë shfrytëzohej nga axha dhe baba i paditëses.
- Në vitin 1988 ndrron jetë z.Ramiz Statovci babai i paditëses duke e lënë pas gruan dhe vajzën e tij si të vetmet trashëgimtare ligjore të pjesës së pronës, e cila sipas ligjit i takonte tani të ndjerit;
- Vajza e të ndjerit Ramiz Statovci, znj. Afërdita Statovci në vitin 2006 fillon procedurën trashëgimore me qëllim të njohjes së të drejtës ligjore, respektivisht të  $\frac{1}{2}$  së pronës të cilën babai dhe axha i saj e kishin blerë në vitin 1975;
- Paditësi Afërdita Statovci në pajtim me ligjin mbi Procedurën Kontestimore dhe Ligjin mbi Trashëgiminë, ushtron padi ndaj shitësit dhe axhës për bartjen e patundshmërisë, dhënies së tapisë dhe përcaktimit të së drejtës së patundshmërisë;
- Gjatë procesit gjyqësor, sipas padisë së znj. Afërdita Statovci lidhur me pronën e lartë-përmendur, trashëgimtarët e shitësit të pronës, përkatësisht trashëgimtari ligjor i shitësit tani të ndjerë në seancë gjyqësore kishte pranuar se prona ishte blerë nga babai i paditëses (*Afërdita Statovci*) kurse i padituri tjetër përkatësisht axha i paditëses kishte kundërshtuar padinë me faktin se në listën e trashëgimtarëve duhet të hyjnë edhe hallat e paditëses dhe kishte larguar paditësen nga posedimi i pasurisë kontestuese.
- I padituri nuk ka ofruar dëshmi se prona objekt i kontestit është blerë si rezultat i shit-bletjes nga pronat e gjyshit, për çka pretendohet nga ana e të paditurit.

### **III. Kronologjia e zvarritjes 13 vjeçare (2006-2019) të procesit gjyqësor për trashëgimi të znj. Afërdita Statovci**

1. Rasti civil i Afërdita Statovci ka filluar me datë **27/02/2006** kur e njëjta përmes padisë kërkon njohjen e të drejtës në trashëgimisë
2. Me datë **26/06/2009** ish-Gjykata Komunale në Prishtinë merr Aktgjykim me të cilën paditëses Afërdita Statovci **i aprovohet padia si e bazuar dhe e njëjta fiton të drejtën nga baza e trashëgimisë si pronare e ½ pjesë ideale e pronës së kontestuar**. Në këtë procedurë nëna e znj Statovcit kishte hequr dorë nga pjesa e saj e trashëgimisë në favor të paditëses znj. Afërdita Statovci. Ky aktgjykim merr formën e prerë me klauzulën e datës **15/10/2009**.
3. Ish-Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktvendimin nr.204/2006 të datës **12/11/2009 ka hequr klauzolën e plotfuqishmërisë** të po të njëjtit aktgjykim ku znj. Statovci kishte fituar të drejtën në trashëgimi.
4. Znj. Statovci, kishte parashtuar ankesë kundër këtij aktvendimi ku ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë me aktvendimin e datës **02/06/2010**, kishte aprovuar ankesën dhe kishte prishur aktvendimin e ish-Gjykatës Komunale, duke e kthyer në rishqyrtim çështjen e heqjes së klauzolës së plotfuqishmërisë.
5. Ish-Gjykata Komunale në Prishtinë, përkatësisht ish-Kryetari i kësaj Gjykate z. Nuhi Uka (*tani i ndjerë*) duke vendosur në rishqyrtim me aktvendimin e datës **14/10/2010**, **heq klauzolën e plotfuqishmërisë nga vendimi i plotfuqishëm me të cilin znj. Afërdita Statovci i ishte njohur e drejta në trashëgimi**.
6. Ish-Gjykata e Qarkut në Prishtinë duke shqyrtuar pretendimet ankimore të paditurit me Aktvendimin e datës **13/01/2012**, prish Aktgjykimin C.nr.204/2006 të datës 26/06/2009 dhe çështjen ia kthen në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
7. Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin C.326/12 të datës **23/09/2016** në procedurën e rishqyrtimit përsëri njeh të drejtën e trashëgimisë për znj. Afërdita Statovci.
8. Gjykata e Apelit në Prishtinë duke vendosur në pretendimet ankimore të palës së paditur me Aktvendimin Ac.4678/16 të datës **02/05/2019**, aprovon ankesën e palës së paditur dhe lëndën ia kthen në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.
9. Gjykata Themelore në Prishtinë e regjistron lëndën e kthyer në rigjykim me numrin C.1523/2019 dhe e njëjta pritet të caktohet.

#### **IV. Shkeljet e parimeve dhe dispozitave kushtetuese dhe ligjore në trajtimin e rastit të znj. Afërdita Statovci**

1. Parimet kushtetuese lidhur me trajtimin e lëndës në një afat të arsyeshëm kohor;
2. Parimet kushtetuese lidhur me të drejtën efektive të mjeteve juridike;
3. 13 vite paditëses znj. Afërdita Statovci i mohohet e drejta e garantuar me kushtetutë e shfrytëzimit të pronës;
4. Gjykatat në Kosovë kanë vendosur kundër parimeve bazë të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e cila bazohet në parimet e lirisë, barazisë, respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mos diskriminimit, të drejtës së pronës.
5. Gjykatat në Kosovë kanë vendosur në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut për një proces gjyqësor të drejtë, paanshëm dhe në kohë të arsyeshme, praktikë kjo e obligueshme sipas nenit 53 të Kushtetutës së Kosovës.
6. Gjykata përmes këtij rasti ndërton praktika diskriminuese ndaj grave dhe të drejtave të tyre në pronë dhe realizimin e tyre në trashëgimi, që bie në kundërshtim me vlerat e rendit kushtetues dhe juridik në Kosovë dhe politikat dhe strategjitë shtetërore,
7. Për më tepër këtë çështje të shqyrtimit të tashëgimisë nga viti 2006 deri më tani e kanë trajtuar 16 gjykatës dhe nga kjo vërehet se ky sistem i drejtësisë përmes kësaj mënyre të trajtimit të rasteve nuk ofron siguri juridike për qytetarët e vendit.